



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/323
Datë: 15/11/2022

Për: Zyrën e shërbimit për çështje të studentëve në AQ

Nga: Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Lënda: Njoftim lidhur me plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e komunitetit jo shumicë në studimet e doktoratës për vitin akademik 2022/2023 në Fakultetin e Mjekësisë

Të nderuar,

Ju njoftojmë se, Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datë 8.11.2022 ka shqyrtuar kërkesën e dekanes së Fakultetit të Mjekësisë për plotësimin e tri (3) vendeve të lira në kategorinë e komunitetit jo shumicë në Programin Shëndet Publik një (1) vend i lirë, Programin Mjekësi Paraklinike një (1) vend i lirë, dhe në Programin Mjekësi Klinike një (1) vend i lirë.

Senati i UP-së me qëllim të mos mbetën vendet e lira nga kategoria e komunitetit jo shumicë në programet: Shëndet Publik, Mjekësi Paraklinike, dhe Programin Mjekësi Klinike, në të cilat programe nuk ka aplikuar asnjë kandidat nga komuniteti jo shumicë në konkursin e shpallur publik për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2022/2023, me nr. prot. 3/168, datë 27.9.2022, ka vendosur që plotësimi i vendeve për komunitetin jo shumicë të bëhet sipas ranglistës së pikëve me kandidatët të cilët e kanë kaluar pragun e kalueshmërisë dhe që i takojnë komunitetit shumicë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Me respekt,

Senati i Universitetit të Prishtinës

Prof. ass. dr. Luljeta Plakolli Kasumi - Kryesuese



Njoftimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Fakultetit të Mjekësisë;
3. Shërbimit për çështje të studentëve në AQ;
4. Zyrës Ligjore të UP-së.